FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 135

Tiranë – E enjte, 13 tetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13859, datë 10.10.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16777
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 13.10.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik", të ndryshuar.....	16777
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 647, datë 5.10.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar.....	16779
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 28, datë 10.10.2022	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, "Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistrimi", i ndryshuar.....	16780
Vendim i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut datë 15.9.2022	Çështja Habilaj kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 2480/10)*.....	16780
Vendim i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut datë 15.9.2022	Genc Bushati kundër Shqipërisë dhe dy kërkesa të tjera (*kërkesa nr. 10893/09)*.....	16784
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 240, datë 29.9.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele", miratuar me vendimin nr. 261, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.....	16785
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 252, datë 6.10.2022	Mbi kërkesën e shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.7.2022, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'C&S Construction Energy' sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011, 'Për licencimin e shoqërisë 'Dosku-Energy' sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike' dhe heqjen e licencës së shoqërisë 'Dosku Energy' sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike'".....	16790

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 253, datë 6.10.2022	Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për heqjen e licencës së shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	16792
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 254, datë 7.10.2022	Mbi një ndryshim në vendimin nr. 242, datë 23.9.2022, të Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë, me konsum mbi 800 kwh në muaj.....	16794

DEKRET
Nr. 13859, datë 10.10.2022

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "c", dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 6**,** nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesën e tyre, personave të mëposhtëm:

1. Rabina Bardhyl Sufaj
2. Rrezarta Ismail Krasniqi
3. Nesim Xhevit Toçilla
4. Çlirim Basri Petrovci
5. Irlinda Vesel Kolukaj
6. Durrëse Mustafë Krasniqi
7. Mentor Mesud Muharremi
8. Bujar Mesud Muharremi
9. Valon Afrim Cahani
10. Rexhep Hasan Nuza
11. Vlora Remzi Hyseni (Toçilla)
12. Ardinist Adem Sufaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

AKT NORMATIV
Nr. 15, datë 13.10.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9880, DATË 25.2.2008, "PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 16, e nenit 3, shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 10 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Autoriteti është institucion juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit.".

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të Autoritetit rregullohen në bazë të Kodit të Punës.".

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

"5/1. Drejtori i përgjithshëm dhe nëpunësit e njësive teknike të përmbajtjes së Autoritetit, përveç pagës sipas kategorive të pagës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune, në masën deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë në muaj. Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për secilën kategori përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 10/1
Emërimi, lirimi ose shkarkimi i drejtorit të përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit të shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, "Master shkencor" apo "Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike" ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë, në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT) apo inxhinieri elektronike;

ç) të ketë përvojë pune të paktën 10 vjet në profesion;

d) të shquhet për aftësi profesionale në fushën e sigurisë;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ë) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit lirohet nga detyra, kur:

a) plotësohen kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

c) ristrukturohet institucioni;

ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm të interesit;

d) jep dorëheqjen nga detyra.

3. Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit shkarkohet nga detyra, kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

b) nuk përmbushen objektivat strategjikë, për shkak të performancës së ulët të tij;

c) kryen shkelje të rënda të detyrës.".

Neni 4

Në fjalinë e parë, të nenit 55, fjalët " ... me propozimin e ministrit përgjegjës, ..." hiqen.

Neni 5

Neni 58 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 58

Ankimi dhe ekzekutimi

1. Kundër vendimit të dënimit me gjobë apo masave të ndërprerjes së veprimtarisë bëhet ankim në gjykatën kompetente administrative, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen, në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

3. Gjoba është titull ekzekutiv, që vilet nga Autoriteti dhe derdhet në buxhetin e shtetit.".

Neni 6

Në pikën 2, të nenit 59, fjalët " ... ministri përgjegjës ..." zëvendësohen me " ... Kryeministri ... ".

Neni 7

Dispozitë kalimtare

Me miratimin e këtij akti normativ, përjashtimisht për vitin 2022, autorizohet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të negociojë e të nënshkruajë amendimin e marrëveshjes së rinovuar të partneritetit strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë "*Microsoft Corporation*" dhe të dërgojë marrëveshjen e nënshkruar për miratim në Këshillin e Ministrave.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 647, datë 5.10.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 748, DATË 11.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr. 1 zëvendësohet me lidhjen me të një njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Anëtarët e personelit akademik efektivë, që për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore, të miratuar me aktet përkatëse, për çdo orë mësimi, të kryer mbi këtë normë, paguhen, si më poshtë vijon:

a) Kur janë në kategorinë "Profesorë" përfitojnë:

i. për titullin "Profesor", 1 410 (një mijë e katërqind e dhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

ii. për titullin "Profesor i asociuar", 1 295 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

b) Kur janë në kategorinë "Lektorë", përfitojnë 940 (nëntëqind e dyzet) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

c) Kur janë në kategorinë "Asistent lektorë", përfitojnë 705 (shtatëqind e pesë) lekë për çdo orë 60-minutëshe.".

II. Përballimi i efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, është, si më poshtë vijon:

1. Për nivelet e pagave sipas kufirit minimal (kolona 2, e lidhjes nr. 1) dhe përcaktimit të pikës 2, të ndarjes I, të këtij vendimi, efektet financiare përballohen për vitin 2022 nga fondet e paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, ndërsa për vitin 2023 e në vijim nga fondet grant për institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Për çdo nivel page të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal (kolona 3, e lidhjes nr. 1), efektet financiare të diferencave midis nivelit të pagës së miratuar dhe atij minimal përballohen nga të ardhurat e veta të institucioneve publike të arsimit të lartë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 tetor 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Nr. rendor	Pozicioni/kategoria	Paga	
		Kufiri minimal	Kufiri maksimal
	1	*2*	*3*
1	Rektor (titullar i institucionit) me titullin "Profesor"	149 500	160 700
2	Zëvendësrektor me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar"	141 500	152 000
3	Zëvendësrektor me gradën shkencore "Doktor (PHD)"	139 600	150 000
4	Dekan me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar"	141 500	152 000
5	Zëvendësdekan me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar"	129 500	139 200
6	Zëvendësdekan nga kategoria "Lektorë"	114 200	122 700

7	Përgjegjës i njësisë bazë me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar"	132 500	142 400
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Lektorë"	114 200	122 700
9	Titullar i grupit mësimor/ kërkimor me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar"	132 500	142 400
10	Titullar i grupit mësimor/ kërkimor nga kategoria "Lektorë"	114 200	122 700
11	Profesor	129 500	139 200
12	Profesor i Asociuar	112 500	121 000
13	Lektorë	96 700	103 850
14	Asistent Lektorë	78 500	84 400

UDHËZIM
Nr. 28, datë 10.10.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 31, DATË 26.12.2013, "PËR EMETIMIN NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË OBLIGACIONEVE NË FORMË REGJISTRIMI", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe neneve 5 dhe 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, "Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi", bëhet një ndryshim si më poshtë:

Neni 1

Pika 1 e nenit 9, ndryshohet si vijon :

Shuma minimale e lejuar për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve në lekë është 300,000.00 (treqind mijë) lekë, ndërsa shuma minimale për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve në valute është 3,000.00 (tre mijë) euro/USD.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi pas Botimit ne Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA HABILAJ KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 2480/10)

VENDIM
STRASBURG
15 shtator 2022

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues

Në çështjen Habilaj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komision i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*
Darian Pavli,
Mikhail Lobov, g*jyqtarë*
dhe Viktoriya Maradudina, *sekretar i Seksionit,*

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 25 gusht 2022,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja nisi me një kërkesë kundër Shqipërisë paraqitur në Gjykatë në mbështetje të genit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 18 shkurt 2009.

2. Kërkuesi i prezantua nga Z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

3. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u njoftua për kërkesën.

FAKTET

4. Detajet e kërkuesit dhe informacionet që kanë lidhje me kërkesën, paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

5. Kërkuesi u ankua për zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme. Gjithashtu, ai ngriti edhe ankesa të tjera sipas Konventës.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS

6. Kërkuesi u ankua kryesisht për zbatimin e vonuar të një vendimi të brendshëm dhënë në favor të tij. Ai u mbështet në nenin 6§1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

Neni 6§1

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, … nga [një] gjykatë… në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile…"

7. Gjykata thekson se ekzekutimi i vendimit të dhënë nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë integrale e "dëgjimit", në përputhje me qëllimet e nenit 6. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës së saj gjyqësore në lidhje me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme të formës së prerë (shih *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, §40, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 1997-II).

8. Në çështjet kryesore *Qufaj Co. Sh.p.k. kundër Shqipërisë* , nr. 54268/00, 18 nëntor 2004, dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009, Gjykata konstatoi një shkelje në lidhje me problematikat e ngjashme me ato në çështjen konkrete.

9. Në çështjen në fjalë, kërkuesi u ankua se vendimi i datës 28 shtator 2005, i Gjykatës së Apelit, Tiranë, i cili urdhëron përfshirjen e tij në listën e kreditorëve të kompanisë Vefa Holding sh.p.k. u zbatua nga autoritetet me shtatë vjet vonesë.

10. Gjykata vëren se vendimi i datës 28 shtator 2005 u apelua në Gjykatën e Lartë. Më 1 shkurt 2008, Gjykata e Lartë vendosi të linte në fuqi vendimin e datës 28 shtator 2005. Më 12 mars 2009, Gjykata Kushtetuese i përfundoi procedurat, pasi kërkuesi tërhoqi ankesën e tij kushtetuese, ku ankohej për shkeljen e së drejtës së tij për t'u dëgjuar drejtësisht, si rezultat i moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, Tiranë. Gjykata vëren se, në periudhën përkatëse, në legjislacionin shqiptar nuk kishte ndonjë mjet efektiv për vonesat në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë (shih *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, §§ 53-61, 29 shtator 2009), kështu, në kohën kur kërkuesi paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë, ekzistonte një situatë e vazhdueshme në lidhje me moszbatimin e vendimeve, pa një mjet kombëtar. Gjithashtu, Gjykata thekson se kërkuesi nuk mund të gjykohet se ka përdorur një mjet teksa Gjykata nuk ka vendosur ende për përputhshmërinë e tij me nenin 35 të Konventës (shih për një qasje të ngjashme së fundmi, *Timofeyev dhe Postupkin kundër Rusisë*, nr. 45431/14 dhe 22769/15, § 112, 19 janar 2021). Në përputhje me rrethanat, përllogaritja e kohëzgjatjes së moszbatimit do të fillojë nga data 12 mars 2009. Në përputhje me rrethanat, përllogaritja e kohëzgjatjes së moszbatimit do të fillojë nga data 12 mars 2009.

11. Gjykata vëren se sipas parashtrimeve të palëve, vendimi i gjykatës u zbatua më 24 gusht 2012, me anë të vendimit nr. 24, i cili urdhëronte përfshirjen e kërkuesit në listën e kreditorëve të kompanisë Vefa sh.p.k, sipas administrimit të detyruar, ku kërkuesit iu paguan 4,711,353 lekë shqiptarë (ALL) (përafërsisht 38,713.2 euro (EUR)). Vendimi u zbatua me mbi tre vjet dhe pesë muaj vonesë.

12. Duke marrë në konsideratë praktikën e saj gjyqësore në lidhje me çështjen konkrete, Gjykata gjykon se në këtë çështje autoritetet nuk bënë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të ekzekutuar vendimin plotësisht dhe brenda afatit në favor të kërkuesit.

13. Për këtë arsye, kjo kërkesë është e pranueshme dhe konstaton një shkelje të nenit 6§1 të Konventës.

II. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA NË MBËSHTETJE TË PRAKTIKËS GJYQËSORE TË KONSOLIDUAR

14. Kërkuesi u ankua edhe në mbështetje të nenit 13 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, për zbatimin e vonuar të vendimit të brendshëm në fjalë. Sipas fakteve të çështjes, parashtrimeve të palëve dhe konstatimeve të mësipërme, Gjykata gjykon se ajo e ka shqyrtuar çështjen kryesore ligjore që ngrihet në kërkesën konkrete. Në këtë mënyrë, ajo konstaton se ankesat e tjera të kërkuesit janë të pranueshme, por nuk është e

nevojshme që për to të jepet një vendim i veçantë (krahaso *Qendrën për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DH], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

III. ANKESAT E TJERA

15. Kërkuesi u ankua edhe për faktin se pasi avokati i tij kishte paraqitur në Gjykatë një faturë të paguar nga kërkuesi për të provuar pretendimet e tij për kompensim të drejtë, Avokati i Shtetit kishte vërtetuar nëse avokati i tij i kishte deklaruar ato kosto edhe tek autoritetet e taksave dhe tatimeve, përpara se Gjykata, në mbështetje të parashtrimit të pretendimeve për kompensim të drejtë, të konstatonte një pengesë në ushtrimin e të drejtës së tij për kërkesë individuale, në mbështetje të nenit 34 të Konventës.

16. Gjykata thekson se origjina e ankesës në mbështetje të nenit 34 të Konventës, është e një natyre procedurale, dhe për këtë arsye, nuk përbën asnjë problematikë për pranueshmërinë, sipas Konventës (shih, *Cooke kundër Austrisë,* nr. 25878/94, § 46, 8 shkurt 2000, dhe *Ergi kundër Turqisë*, 28 korrik 1998, § 105, *Raportet e gjykimeve dhe të vendimeve* 1998-IV).

17. Gjykata konstaton se për operimin efikas të sistemit të kërkesës individuale, në mbështetje të nenit 34, është e një rëndësie themelore që kërkuesit të kenë mundësinë të komunikojnë në mënyrë të hapur me organet e Konventës, pa iu nënshtruar ndonjë forme presioni nga autoritetet për të tërhequr, apo për të modifikuar ankesat e tyre. Shprehja "ndonjë formë presioni" duhet të interpretohet jo vetëm për trajtimin e shtypjes së drejtpërdrejtë dhe akteve flagrante të frikësimit të kërkuesve, apo të përfaqësuesve të tyre ligjor, por edhe veprimeve të tjera të papërshtatshme jo të drejtpërdrejta, apo kontakteve me qëllimin për t'u hequr bindjen apo për t'i dekurajuar që të ndjekin një mjet të Konventës (shih *Tanrıkulu kundër Turqisë* [DHM], nr. 23763/94, § 130, GJEDNJ 1999-IV, me referenca të tjera dhe *Kurt kundër Turqisë,* 25 maj 1998, § 160, *Raportet* 1998-III).

18. Gjykata vëren se një linjë e tillë masash e ndërmarrë nga autoritetet mund të ketë çuar në interpretimin e saj nga ana e kërkuesit si një përpjekje për ta frikësuar me anë të përfaqësuesit të tij.

19. Megjithatë, çështja, nëse autoritetet kanë marrë një masë të debatueshme që ka të bëjë me praktika të papranueshme nga këndvështrimi i nenit 34, duhet të përcaktohet në mbështetje të rrethanave specifike të çështjes (shih, midis të tjerash, *Kurt*, cituar më sipër, §160).

20. Në çështjen konkrete, veçanërisht, në lidhje me fushën e veprimit të masave të autoriteteve dhe me faktin se as kërkuesi dhe as avokati i tij nuk ishin në një pozicion veçanërisht vulnerabël, Gjykata mendon se rrethanat e hetimit nuk arrijnë pragun e masës në kundërshtim me detyrimet e Shteteve Anëtare, sipas nenit 34 të Konventës, dhe se kjo kërkesë e ankuesit duhet të rrëzohet.

21. Kërkuesi u ankua edhe në mbështetje të një sërë parashikimesh të Konventës, se nuk kishte përfituar kompensim për shumën e plotë që kishte investuar në kompaninë "Vefa Holding" sh.p.k., sipas administrimit të detyruar. Gjykata e ka shqyrtuar këtë pjesë të kërkesës dhe gjykon se, në mbështetje të të gjithë materialit që ajo zotëron dhe për aq sa ankesat janë në kompetencën e saj, këto ankesa nuk përmbushin kriteret e përputhshmërisë të parashikuara në nenet 34 dhe 35 të Konventës, duke qenë se janë ngritur përtej afatit gjashtë mujor.

22. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§1 dhe 4 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

23. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

24. Në mbështetje të dokumenteve që ajo zotëron dhe praktikës së saj gjyqësore (shih, veçanërisht, *Qufaj Co. Sh.p.k.*, cituar më sipër, §§62-76), Gjykata e konsideron të arsyeshme që të japë shumat e paraqitura në tabelën bashkëlidhur.

25. Gjithashtu, Gjykata e konsideron me vend që norma e interesit të pashlyer duhet të mbështetet në normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane së cilës i duhen shtuar tre për qind pikë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. I deklaron ankesat në lidhje me zbatimin e vonuar të vendimit të brendshëm, sipas nenit 6 të Konventës, dhe ankesat e tjera në mbështetje të

praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës (shih tabelën bashkëlidhur) të pranueshme, dhe ankesat në lidhje me mospagimin e kompensimit të plotë të papranueshme;

2. Gjykon se kjo kërkesë konstaton një shkelje të nenit 6§1 të Konventës në lidhje me zbatimin e vonuar të vendimit të brendshëm;

3. Gjykon se nuk është e nevojshme që të shqyrtohen ankesat e tjera, sipas praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës (shih tabelën bashkëlidhur);

4. Gjykon se Shteti i paditur nuk dështoi në respektimin e detyrimeve të tij sipas nenit 34 të Konventës;

5. Gjykon:

a) Se Shteti i Paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve, shumat e paraqitura në tabelën bashkëlidhur, të cilat do të konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) Se që prej përfundimit të periudhës së sipërpërmendur tre mujore deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e sipërpërmendura në një normë të barasvlershme me normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhë së paracaktuar plus tre për qind pikë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 15 shtator 2022, sipas Rregullit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Viktotiya Maradudina
Zëvendëssekretare
e Përkohshme

Andreas Zünd
Kryetar

SHTOJCË 1

Kërkesa e cila ngre ankesa në lidhje me Nenin 6 § 1 të Konventës
(moszbatim ose zbatim i vonuar i vendimeve të brendshme)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuesit Viti i lindjes	Emri i përfaqësuesit dhe vendndodhja	Vendimi përkatës i brendshëm	Data e fillimit të periudhës së moszbatimit	Përfundimi i periudhës së moszbatimit Kohëzgjatja e procedurave të ekzekutimit	Akordimi i brendshëm (në euro)	Detaje të urdhrit të ekzekutimit	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar	Shuma akorduar për dëmin jopasuror për kërkues (në euro)[1]	Shuma e akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkesë (në euro)[2]
2480/10 18/02/2009	**Gjergji HABILAJ** 1954	Hajdari Artan Tiranë	Gjykata Kushtetuese 12/03/2009	12/03/2009	24/08/2012 3 vite dhe 5 muaj dhe 13 ditë	Emri i kërkuesit duhet të përfshihet në listën e kreditorëve të kompanisë me përgjegjësi të kufizuar Vefa Holding sh.p.k, sipas administrimit të detyrueshëm nga Shteti	Urdhri i ekzekutimit të Gjykatës së Apelit, Tiranë, nr. 114 i datës 10/11/2005	Neni 13 – mungesa e mjeteve efikase në legjislacionin e brendshëm për moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme Prot. Nr. 1, Neni 1 – ndërhyrje në gëzimin paqësor të zotërimeve të tij, në lidhje me zbatimin e vonuar të gjykimeve të formës së prerë	1,800	250

[1] Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.
[2] Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 10893/09

Genc BUSHATI kundër Shqipërisë
dhe dy kërkesa të tjera
(shih tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 25 gusht 2022, si Komision, i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit,*

Pasi morën në konsideratë kërkesat e mësipërme paraqitur në data të ndryshme, sipas tabelës bashkëngjitur,

Pasi mori në konsideratë parashtrimet e paraqitura nga Qeveria e paditur, si edhe parashtrimet e kërkuesit si përgjigje ndaj të parave,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkuesve gjendet në tabelën bashkëngjitur.

Kërkuesi i parë u përfaqësua nga Z. B. Muslija, një avokat, i cili e ushtron profesionin në Shkodër. Kërkuesi i dytë dhe i tretë u vetëpërfaqësuan.

Ankesat e kërkuesve sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile, së bashku me ankesat e tyre sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me vonesën në shlyerjen e kompensimit ndaj tyre, iu komunikuan Qeverisë shqiptare ("Qeveria"). U komunikuan gjithashtu edhe kërkesat nr. 11170/09 dhe 49039/11 *ex officio*, sipas nenit 13, në lidhje me çështjen nëse kërkuesit kishin në dispozicion një mjet efikas të brendshëm për t'u ankuar për kohëzgjatjen e procedurave civile.

LIGJI

A. Bashkimi i kërkesave

Duke marrë në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjykon me vend që t'i shqyrtojë së bashku, si një vendim i vetëm.

B. Ankesa në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës (kohëzgjatje e tepruar e procedurave civile)

Kërkuesit u ankuan në mbështetje të nenit 6 për faktin se kohëzgjatja e procedurave administrative përpara Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me dhënien e vendimit për pretendimet e tyre për kompensim ishte në shkelje me kushtin për "afat të arsyeshëm" sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

Duke marrë në konsideratë nenin 6§1, i cili parashikon të drejtën për t'u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm përpara një gjykate, Gjykata vëren se ky nen nuk zbatohet për procedurat plotësisht administrative, si ato në çështjen në fjalë (krahaso *Blake kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 68890/01, §40, 26 shtator 2006, me referenca të tjera).

Për këtë arsye, në lidhje me kohëzgjatjen e pretenduar të procedurave përpara Ministrisë së Drejtësisë, Gjykata thekson se ky autoritet nuk është një "gjykatë". Në përputhje me rrethanat, kjo pjesë e kërkesës nuk përputhet *ratione materiae* me Konventën dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3 dhe 4 të Konventës.

C. Ankesa sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës

Ankesa e kërkuesit për shlyerjen e vonuar të kompensimit të tyre nga autoritetet si ish-të burgosur politikë gjatë regjimit Komunist, shqyrtohet sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Gjykata thekson se shtetet përjashtohen nga kërkesa që të përgjigjen përpara një organi ndërkombëtar për masat e tyre, përpara se të kenë mundësinë që t'i zgjidhin çështjet me anë të sistemit të tyre ligjor, dhe ata që dëshirojnë të kërkojnë juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës, për sa ka të bëjë me ankesat ndaj një Shteti, janë të detyruar të përdorin fillimisht mjetet e ofruara nga sistemi i brendshëm ligjor (shih *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* (kundërshtim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §70, 25 mars 2014, me referenca të tjera). Në kërkesat konkrete, kërkuesit nuk e kundërshtuan zbatimin e vonuar të vendimit administrativ i cili u akordonte kompensim përpara gjykatave të brendshme administrative.

Kjo pjesë e kërkesave duhet të deklarohet e papranueshme pasi mjetet e brendshme nuk janë shteruar sipas nenit 35 § 1 të Konventës.

D. Shkelje të tjera të pretenduara të Konventës

Në lidhje me ankesat e tjera të paraqitura nga kërkuesit, Gjykata është e mendimit se, në mbështetje të të gjithë materialit që ajo zotëron, dhe për sa çështjet për të cilat është bërë një ankesë janë në kompetencën e saj, këto ankesa ose nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenet 34 dhe 35 të Konventës, ose nuk paraqesin ndonjë formë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë ose në protokollet e saj.

Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesave duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35§4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos t'i bashkojë kërkesat;

I deklaron kërkesat të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 15 shtator 2022.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE E PËRKOHSHME

Andreas Zünd
KRYETAR

SHTOJCË
Lista e ankesave të cilat parashtrojnë ankesa sipas nenit 6§1 të Konventës
(kohëzgjatje e tepërt e procedurave civile)

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuesit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit
1	11170/09 21/11/2008	**Genc BUSHATI** 1944	Muslija Bashkim SHKODËR
2	65326/09 07/10/2009	**Osman MENA** 1959	
3	49039/11 13.06.2011	**Nazmi JUSUFI** 1939	

VENDIM
Nr. 240, datë 29.9.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR TRANSFERIMIN E PROKURORËVE NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 261, DATË 17.11.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 42 dhe 43, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar; si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- Miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren "*Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele*", si më poshtë:

Neni 1

Në të gjithë tekstin e rregullores, togfjalëshi "*këtij vendimi*", bëhet "*kësaj Rregulloreje*";

Neni 2

Në nenin **2**, **paragrafi i parë**, pas termit "*të bëhen*" shtohet termi "*të lira në mënyrë*";

Neni 3

Në nenin **4**, pika "**iv**" e germës "**f**", shfuqizohet;

Në nenin 4, germa "**i**"; pas togfjalëshit "*Shkollën e Magjistraturës*" shtohet termi "*në organizata ndërkombëtare*";

Në nenin **4** shtohet germa "**th**" me këtë përmbajtje:

"Përvojë specifike profesionale" nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit, e cila i referohet eksperiencës së mëparshme të kandidatit në ushtrimin e kompetencave dhe kryerjen e detyrave që lidhen me atë pozicion, gjatë një periudhe kohore të specifikuar të mëparshme, duke përfshirë edhe përvojat profesionale të posaçme të thelluara, të tilla si në Prokurorinë e Posaçme, Apelit apo Prokurorinë e Përgjithshme, kërkimet shkencore të certifikuara me tituj e grada akademike".

Neni 4

Neni **5** ndryshon si më poshtë:

1. Këshilli organizon, të paktën çdo 3 muaj, procedurën e lëvizjes paralele për çdo pozicion që është i lirë ose që pritet të bëhet i lirë brenda 3 muajve, në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, me përjashtim të rasteve kur:

a) Nuk ka pozicion të lirë ose që pritet të bëhet i lirë;

b) Kjo mund të passjellë cenim të rëndë të funksionalitetit të prokurorive.

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, komisioni në fillim të çdo tremujori i paraqet Këshillit relacionin përkatës ku pasqyron të gjitha vendet e lira në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm dhe i propozon Këshillit:

a) të organizojë procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për të gjitha ose vetëm për disa nga pozicionet e lira;

b) të shtyjë organizimin e procedurave të lëvizjes paralele për të gjitha pozicionet e lira deri në verifikimin e situatës së moscenimit të rëndë të funksionalitetit të prokurorive.

3. Shpallja e procedurës së lëvizjes paralele për çdo pozicion të lirë bëhet me vendim të Këshillit, mbi propozimin e Komisionit. Këshilli shprehet me vendim edhe në rastet e mos hapjes së procedurës për vendet e lira.

4. Në vendimin e hapjes së procedurës së lëvizjes paralele Këshilli përcakton:

a) kushtet ligjore të kandidimit;

b) afatin e kandidimit, i cili mund të jetë nga dy deri në katër javë nga data e shpalljes së procedurës;

c) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;

ç) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit;

d) të drejtën për të kandiduar deri në 3 pozicione të lira, duke i renditur ato sipas preferencës.

5. Prokurori i interesuar mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira të shpallura, që janë në proces. Prokurori i interesuar që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës. Nëse prokurori i interesuar:

a) nuk ka përcaktuar pozicionet për të cilat kandidon, do të ftohet nga Komisioni që brenda 3 ditëve të bëjë përcaktimin e tyre dhe renditjen sipas preferencës. Komisioni përcakton kandidimet e vlefshme sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë, në rast të mos përcaktimit të tyre nga prokurori i interesuar brenda afatit.

b) rendit në kërkesën e tij më shumë se 3 pozicione të lira, atëherë kandidime të vlefshme konsideron vetëm 3 pozicionet e para në renditje.

c) nuk ka renditur pozicionet sipas preferencës, atëherë kandidime të vlefshme do të konsiderohen tri pozicionet e para, sipas citimit në kërkesë.

ç) kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme do të konsiderohen, 3 pozicionet për të cilat kandidimi është bërë më parë në kohë. Në numrin e pozicioneve nuk llogariten pozicionet nga të cilat kandidati është tërhequr.

Neni 5

Në nenin **6**, pika **1**, pas togfjalëshit "*për shpalljen e lëvizjes paralele*" shtohet fjalia: "*dhe vetëdeklarimin për mos qenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të ligjit për statusin*";

Në nenin **6**, pika **2**, pas termit "*Komisioni*" shtohet termi "*ose relatori*";

Neni 6

Neni **7**, pika **1** ndryshon si më poshtë:

1. Komisioni identifikon pozicionet e lira apo që pritet të bëhen të lira brenda 3 muajve. Pozicioni i lirë i përhershëm në prokurorinë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm plotësohet me radhë si më poshtë:

a) nga një prokuror i caktuar përkohësisht në këtë pozicion, i cili paraqet kërkesë për caktimin e përhershëm, në rastin e ndryshimit nga Këshilli të këtij pozicioni nga i përkohshëm në të përhershëm sipas nenit 59 të Ligjit për Statusin;

b) nga prokurori që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale apo për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të prokurorive;

c) nga magjistratët që transferohen për shkak të lëvizjes paralele.

ç) nga magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë.

Në nenin **7**, pika **3**, **fjalia e dytë**, togfjalëshi "*kësaj rregulloreje*", ndryshohet në "*e këtij neni*";

Neni 7

Në nenin **8**, pika **2** shfuqizohet;

Neni 8

Në nenin **9**, pika **2** pas togfjalëshit "*Për çdo procedurë*" shtohet togfjalëshi "*transferimi nëpërmjet*" si dhe togfjalëshi "*caktohet një*" ndryshohet në "*Këshilli cakton një*";

Neni 9

Në nenin **11**, pika **2**, togfjalëshi "*në nenin 75 të ligjit për qeverisjen*" ndryshohet në "*Ligjin për qeverisjen ose çdo shkak tjetër ligjor*";

Në nenin **11**, pika **8**, pas fjalës "*kërkesën e*" shtohet togfjalëshi "*relatorit, komisionit ose".*

Neni 10

Në nenin **12**, pika **2**, në fund të fjalisë së parë termi "*tij*" ndryshohet në "*Këshillit*" dhe në fjalinë e dytë, termi "*i tij*" hiqet;

Neni 11

Në nenin **15**, pikat **1** dhe **2**, ndryshohen si më poshtë:

1. Komisioni, jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit për një pozicion të lirë, i paraqet Këshillit listën e prokurorëve që kanë kandiduar për pozicionin e lirë, duke cituar edhe prokurorët që kanë kandiduar jashtë afatit.

*2. Këshilli, në mbledhjen më të parë vendos fillimin e verifikimit të kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit, të parashikuara në germat **"a"** deri **"d"** të nenit 8 të kësaj rregulloreje. Në këtë rast, Këshilli përcakton listën e prokurorëve të interesuar që kanë kandiduar për pozicionin e lirë, duke përjashtuar prokurorët që kanë kandiduar jashtë afatit.*

Neni 12

Në nenin **17**, pika **5** shfuqizohet;

Neni 13

Në nenin **23**, pika **1** pas togfjalëshit "*verifikimit të*" shtohet togfjalëshi "*kushteve ligjore të*";

Neni 14

Në nenin **26**, pika **2**, germat "***b***", "***c***" dhe "***ç***" ndryshohen si më poshtë:

b) "përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit për prokurorët të cilëve u ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit, që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar pasi ka kryer të gjithë periudhën e komandimit".- Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

c) "shumëllojshmëria e përvojave, si prokuror në skemën e delegimit, si anëtar i Këshillit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar". - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

ç) "kohëzgjatja e përvojës, si prokuror në skemën e delegimit, si anëtar i Këshillit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar". - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

Në nenin 26, pika 3, pas germës *"b"* shtohen germat *"c"* dhe *"ç"* me këtë përmbajtje:

c) përvoja e magjistratit në pozicione drejtuese të sistemit të prokurorisë;

ç) vlerësimet e mëparshme.

Neni 15

Në nenin **28**, pika **2**, togfjalëshi "*specifikave të pozicionit të lirë*", ndryshohet në "*kohëzgjatjes në atë shkallë*";

Neni 16

Në nenin **29**, pika **3**, termi "*pikëzohet*" ndryshohet në "*vlerësohet*";

Neni 17

Në nenin **31**, pika **2**, në fund shtohet togfjalëshi "*me shumicën e votave*";

Neni 18

Në nenin **33**, pika **1**, ndryshohet si më poshtë:

1. Renditja e kandidatëve bëhet duke u bazuar njëkohësisht në vlerësimin krahasues të:

a) rezultatit të vlerësimit etik dhe profesional përkatës;

b) në rastin e prokurorit të riemëruar sipas nenit 36 të ligjit për statusin, që përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit, që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ose si prokuror i komanduar, do të ketë përparësi;

c) renditjes në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional.

Në pikën 3, togfjalëshi *"sipas shkronjave "a" dhe "b"",* bëhet "*sipas shkronjave "a", "b" dhe "c"".*

Pika 4, germat *"b", "c",* dhe *"ç"* ndryshohen si më poshtë:

b) "përvoja si prokuror i komanduar nga skema e delegimit që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ose si prokuror i komanduar". - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

c) "kohëzgjatja e përvojës si prokuror i komanduar nga skema e delegimit që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ose si prokuror i komanduar". - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

ç) "shumëllojshmëria e përvojave si prokuror i komanduar nga skema e delegimit që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ose si prokuror i komanduar". - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

Neni 19

Neni **35**, **paragrafi i dytë**, togfjalëshi "*specifikave të pozicionit të lirë*", ndryshohet në "*kohëzgjatjes në atë shkallë*";

Neni 20

Në nenin **38**, pika **2**, në fund shtohet togfjalëshi "*me shumicën e votave*";

Neni 21

Neni **40**, pika **2**, germat ***"a", "b"*** dhe **"c"**, ndryshohen si më poshtë:

a) "përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit për prokurorët të cilëve i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit, që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar pasi ka kryer të gjithë periudhën e komandimit". -Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

b) "shumëllojshmëria e përvojave, si prokuror në skemën e delegimit, si anëtar i Këshillit, si Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar". - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

c) "kohëzgjatja e përvojës, si prokuror në skemën e delegimit, si anëtar i Këshillit, si Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar". -Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

Në nenin **40**, pika **4**, termi "*vendimi*" ndryshohet në "*neni*";

Neni 22

Në nenin **41**, pika **2**, në fund shtohet togfjalëshi "*të kësaj rregulloreje*";

Neni 23

Pas nenit **45** shtohet neni **45/1** me përmbajtje:

"Neni 45/1

Përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar

Këshilli vendos përfundimin e një procedure pa vendim përfundimtar në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk është paraqitur asnjë kërkesë për atë procedurë, brenda afatit të caktuar;

b) kur në vijim të procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, nuk mbetet asnjë kandidat në atë procedurë;

c) kur vendi i shpallur nuk është më i lirë;

ç) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj."

Neni 24

Në nenin **46**, pika **3**, ndryshohet si më poshtë:

3. Në rast se, në një procedurë të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele të paktën një nga kandidatët nuk ka asnjë vlerësim sipas ligjit për statusin dhe vlerësimet e tij janë konvertuar sipas parashikimeve të nenit 24 dhe 47 të kësaj rregulloreje, atëherë vlerësimi i çdo kandidati tjetër në atë procedurë, që është bërë sipas ligjit për statusin, do të konvertohet sipas tabelës së mëposhtme:

Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (ligjit për statusin):	***Niveli i vlerësimit pas konvertimit për efekt të procedurës së ngritjes në detyrë:***	***Pikët, pas konvertimit për efekt të procedurës së ngritjes në detyrë:***
Shkëlqyeshëm	*Shkëlqyeshëm*	*100*
Shumë mirë	*Shkëlqyeshëm*	*100*
Mirë	*Mirë*	*69*
Mjaftueshëm	*Mjaftueshëm*	*49*
I pamjaftueshëm	*I pamjaftueshëm*	*29*

Neni 25

Në nenin **47**, ndryshohen tabelat si më poshtë:

Niveli i vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional:	***Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (ligjit për statusin):***
Shumë mirë	*Shkëlqyeshëm*
Mirë	*Mirë*
Mjaftueshëm	*Mjaftueshëm*
I pamjaftueshëm	*I pamjaftueshëm*

Niveli i vlerësimit	***Pikët***
Shkëlqyeshëm	*100*
Mirë	*69*
Mjaftueshëm	*49*
I pamjaftueshëm	*29*

Neni 26

Neni **48**, shfuqizohet.

Neni 27

Në nenin **50**, pika **1**, shfuqizohet.

- Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet edhe në faqen zyrtare *web* të Këshillit.
- U shpall në Tiranë, sot, më 29.9.2022.

KRYETAR
Alfred Balla

VENDIM
Nr. 252, datë 6.10.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "C&S CONSTRUCTION ENERGY" SHPK PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 21.7.2022 "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË 'C&S CONSTRUCTION ENERGY' SHPK PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË ERE-S NR. 67, DATË 27.10.2011 'PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË 'DOSKU-ENERGY' SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE' DHE HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË 'DOSKU ENERGY' SHPK PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE'"

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 3, pika 7, germa "a", nenit 33, pika 1, germa "b", të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 5, pika 23, nenit 15 dhe nenit 16 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, Këshilltari i Bordit dhe Sekretari i Përgjithshëm me nr. 1746-1 prot., datë 5.10.2022, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'C&S Construction Energy' sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.7.2022'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 21.7.2022 ka vendosur, ndër të tjera:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k., për shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011, i ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. për shkelje të kushtit të vendosur në pikën 2.2 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE ka njoftuar shoqërinë "C&S Construction Energy" sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin nr. 188/2022 nëpërmjet shkresës nr. 207/21, datë 1.8.2022.

- Me shkresën e datës 2.9.2022, protokolluar në ERE me nr. 1507/4 prot., datë 6.9.2022, shoqëria "C&S Construction Energy" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rishikimin e këtij vendimi dhe shfuqizimin e vendimit nr. 67, datë 27.10.2011 "Për licencimin e shoqërisë 'Dosku Energy' sh.p.k., si akt i paligjshëm që vjen në kundërshtim me ligjin.

- Shoqëria "C&S Construction Energy" sh.p.k. konsiderohet palë në këtë proces për sa përcaktuar në nenin 3, pika 7, germa "a" dhe nenin 33, pika 1, germa "b", të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenin 5, pika 23 dhe nenin 16, pika 1 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96/2016.

- Për sa i përket afatit për paraqitjen e kërkesës për rishikim, që përbën dhe kushtin e dytë për të paraqitur një kërkesë të tillë, vetë shoqëria "C&S Construction Energy" sh.p.k. ka marrë dijeni për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188/2022 nëpërmjet shkresës 207/24 prot., datë 25.8.2022, për të cilën ka marrë dijeni efektivisht nëpërmjet rrugës postare në datën 29.8.2022.

- Për sa u përket parashtrimeve dhe pretendimeve, se: shoqëria "Dosku-Energy" sh.p.k. nuk ka përmbushur kushtet thelbësore të licencimit të dhënë sipas ligjit e një ndër kushtet është mungesa e kontratës së koncesionit, sqarojmë se: ky pretendim është ngritur dhe më parë dhe është bërë pjesë e shqyrtimit të rrethanave dhe fakteve mbi të cilat është marrë dhe vendimi i Bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.7.2022. Konkretisht, sa i përket kontratës së koncesionit, ERE ka shqyrtuar këtë pretendim dhe janë bërë konstatimet përkatëse në faqen 3, të vendimit të Bordit nr. 188/2022 dhe në këto rrethana kjo nuk përbën provë të re, të tillë që ta çojë Bordin e ERE-s të marrë një vendim të ndryshëm.

- Sa pretenduar në lidhje me lejen e ndërtimit, dokumentacionin pronësor etj., është shqyrtuar gjithashtu gjatë marrjes së vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188/2022 dhe janë bërë konstatimet përkatëse në faqet 3 dhe 4 të këtij vendimi. Po ashtu, shkresa e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr. 1167/4 prot., datë 24.9.2020

drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për dijeni shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k. është marrë gjithashtu në shqyrtim (faqja 3 e vendimit nr. 188/2022). Po ashtu gjatë mbledhjes së Bordit të ERE-s të datës 21.7.2022, nga ana e shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k. është bërë me dije vendimi i nxjerrë nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) për marrjen e masës administrative pezullim të aktivitetit të shoqërisë "Dosku Energy" sh.p.k. Në vijim, nga ana e shoqërisë është depozituar vendimi përfundimtar i inspektimit i IKMT-DQ-2022-000112-5, datë 14.7.2022, nga ku rezulton se bazuar në inspektimin e kryer në subjektin "Dosku-Energy" sh.p.k., janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore në mbështetje të ligjit nr. 112/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 41, pika 1, germa "c" dhe neni 97, pika 3, të cilat klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe për këtë parashikohen dënimet gjobë dhe pezullim i aktivitetit.

Me shkresën nr. 207/22 prot., datë 1.8.2022, ERE ka njoftuar për këtë vendimmarrje Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a., shoqërinë "C&S Construction Energy" sh.p.k., shoqërinë "Dosku Energy" sh.p.k. dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).

Në vijim të sa më sipër, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1507 prot., datë 29.8.2022 dhe nr. 1507/1 prot., datë 1.9.2022, shoqëria "Dosku-Energy" sh.p.k. ka depozituar në ERE vendimin nr. 82-2022-652, datë 22.8.2022, të Gjykatës Adminsitrative të Shkallës së Parë Durrës, ku është vendosur pranimi i kërkesë së shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. për sigurimin e padisë dhe pezullimin e zbatimit të pikës 2, të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. IKMT-DQ-2022-000112-5, datë 14.7.2022, të IKMT-së Drejtoria Qendrore, nëpërmjet së cilës është disponuar dënimi administrativ plotësues "Pezullim i aktivitetit", deri në përfundimin e gjykimit të çështjes administrative me vendim të formës së prerë.

ERE nuk mund të shprehet për këtë çështje sa kohë ajo është në shqyrtim nga një organ gjyqësor. Në çdo rrethanë, duhet theksuar se edhe pasi organi gjyqësor të shprehet me vendim të formës së prerë, që ERE të shprehet në vijim, duhet që ky vendim të afektojë vendimmarrjen e ERE-s në funksion të ushtrimeve të kompetencave të saj dhe vetëm brenda këtyre kompetencave që i njeh ligji material dhe aktet nënligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër nuk rezulton që nga ana e shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë Bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 188/2022.

- Për sa i përket pretendimit në lidhje me lejen për përdorimin e burimit ujor, ai është shqyrtuar gjithashtu në marrjen e vendimit të Bordit nr. 188/2022 (faqja 4). Përveç sa shqyrtuar, sikurse cituar dhe më sipër, shkelja e dispozitave të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, është një çështje e cila po shqyrtohet nga organi kompetent gjyqësor. Nuk rezulton që nga ana e shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë Bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 188/2022.

- Për sa pretenduar nga shoqëria në lidhje me rrezikimin e jetës, shëndetit dhe pasurisë së qytetarëve, e cila përbën dhe një nga kushtet për të filluar procedurën për heqjen e një licence, sqarojmë se është marrë në shqyrtim në vendimin nr. 188/2022 (faqet 5 dhe 6), ku është konstatuar se nuk rezulton që të jetë provuar e dokumentuar se si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria "Dosku Energy" sh.p.k. të jetë rrezikuar jeta apo pasuria e personave të kësaj shoqërie, dokumenti i cili duhet të mbajë vulën e organeve përkatëse që kanë dhe kompetencën për të përcaktuar ardhjen e një pasoje të tillë. Nga ana tjetër për sa i përket pretendimit të shoqërisë në lidhje me vendosjen e kabllos së tensionit të lartë, duke qenë se verifikimi i kushteve apo sigurisë së vendosjes së tij nuk është kompetencë e ERE-s, kjo e fundit ka njoftuar për këtë fakt shoqërinë "C&S Construction Energy" sh.p.k. me shkresën nr. 1507/5 prot., datë 9.9.2022. Po ashtu, me shkresën nr. 1507/6 prot., datë 12.9.2022, ka vënë në dijeni për sa pretenduar nga shoqëria Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) dhe shoqërinë "Dosku-Energy" sh.p.k.

Për sa më sipër nuk rezulton që nga shoqëria "C&S Construction Energy" sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë

Bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 188/2022.

- Shoqëria "C&S Construction Energy" sh.p.k. pretendon se për sa i përket shkeljes së dispozitave për mbrojtjen e mjedisit, shoqëria ka sjellë sërish në vëmendje vendimin e IKMT-së me nr. IKMT-DQ-2022-000112-5, datë 14.7.2022, nëpërmjet të cilit janë marrë masa pasi janë konstatuar shkelje të dispozitave për mbrojtjen e mjedisit. Sqarojmë se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, ka vendosur pezullimin e zbatimit të pikës 2 të këtij vendimi deri në përfundimin e gjykimit të çështjes administrative me vendim të formës së prerë. Në këto rrethana nuk rezulton që nga ana e shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë Bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 188/2022.

- Në përfundim, shoqëria ka kërkuar rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, në mënyrë që të merren parasysh të gjitha pretendimet e saj, pasi nuk ka vetëm shkelje të kushteve të pikës 2.2 të licencës, për sa i përket rritjes së kapacitetit, por edhe shkelje të dispozitave për mbrojtjen e mjedisit, kryerja e punimeve që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe më kryesorja mungesa e kontratës së koncesionit si një nga kushtet thelbësore për dhënien e licencës. Në këto kushte dhe për sa parashtruar, shoqëria "C&S Construction Energy" sh.p.k. ka kërkuar nga ERE që të procedojë me shfuqizimin e vendimit të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011, dhe heqjen e licencës së shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. me nr. 134, seria PV11P.

- Për gjitha sa më sipër pretenduar nga ana e shoqërisë, kusht që Bordi i ERE-s të rishikojë një vendim të tij është paraqitja e provave të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara. Nuk rezulton që nga ana e shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k. të jetë depozituar ndonjë provë e re, e tillë që të çojë Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi nr. 188/2022, ndaj vlerësohet që kërkesa e saj për rishikimin e këtij vendimi duhet të rrëzohet.

- Nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k., të pranishëm në mbledhje, u bë me dije se disponon një tabelë fotografike, të vënë në dispozicion nga Prokuroria Elbasan, ku është realizuar këqyrja e ambienteve të HEC Gizavesh, të datës 12.5.2022, por që shoqëria vetë nuk e ka disponuar më parë këtë dokument. Gjithsesi, duke mos qenë akt/vendim përfundimtar i organeve apo institucioneve, nuk përbën provë të re të tillë që të ndryshojë vendimin e Bordit të ERE-s 188/2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.7.2022 "Mbi kërkesën e shoqërisë 'C&S Construction Energy' sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011 "Për licencimin e shoqërisë 'Dosku-Energy' sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike" dhe heqjen e licencës së shoqërisë 'Dosku-Energy' sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "C&S Construction Energy sh.p.k për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 253, datë 6.10.2022

MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË "DOSKU-ENERGY" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 92, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15, të rregullores "Për

organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, Sekretari i Përgjithshëm dhe Këshilltari i Bordit të ERE-s, nr. 1755/1-1 prot., datë 5.10.2022, "Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për heqjen e licencës së shoqërisë 'Dosku-Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 21.07.2022, ka vendosur, ndër të tjera:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "C&S Construction Energy" sh.p.k., për shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011, i ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. për shkelje të kushtit të vendosur në pikën 2.2 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

3. Shoqëria "Dosku-Energy" sh.p.k. ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

- Me shkresën nr. 207/20 prot., datë 1.8.2022, ERE ka njoftuar për këtë vendim shoqërinë "Dosku-Energy" sh.p.k., Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Në këtë shkresë, shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. i është bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Shoqëria "Dosku-Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1507/2 prot., datë 6.9.2022, ka depozituar parashtrimet e saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 207/23 prot., datë 15.8.2022, shoqëria "C&S Construction Energy" sh.p.k. ka depozituar të dhëna shtesë në lidhje me rritjen e kapacitetit të HEC Gizavesh.

- ERE iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), me shkresën nr. 1495 prot., datë 24.8.2022, me anë të së cilës i ka kërkuar informacion mbi gjetjet në lidhje me kapacitetin e instaluar me të cilin operon HEC-i Gizavesh i shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k., referuar verifikimeve apo monitorimeve të kryera nga ana e saj.

- Duke qenë se nga ana e AKBN-së nuk pati kthim përgjigjeje, me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 110, datë 8.9.2022, u urdhërua monitorimi i shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k., me objekt verifikimin e kapacitetit të instaluar faktik krahasuar me kapacitetin e instaluar dhënë në licencën përkatëse.

- Në vijim të monitorimit të realizuar në datat 13-15.9.2022, grupi i monitorimit përgatiti informacionin përkatës nr. 454/5 prot., datë 27.9.2022 i cili, në zbatim të nenit 13, pika 4, të "Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 27.11.2020, ka përgatitur informacionin përkatës, i cili i është nisur shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. me shkresën nr. 454/6 prot., në datën 27.9.2022. Në shkresë referohet se brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e saj duhet të bëhet me dije në ERE qëndrimi apo kundërshtimi mbi sa konstatuar në informacionin përkatës. Gjithashtu, kjo shkresë është dërguar dhe me e-mail, në datën 28.9.2022.

- Shoqëria "Dosku-Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454/7, datë 5.10.2022 ka kthyer përgjigje lidhur me informacionin e përgatitur nga grupi i monitorimit i ERE-s, dërguar me shkresën nr. 454/6 prot., në datën 27.9.2022 shoqërisë.

- Po ashtu, ERE iu drejtua sërish AKBN-së me të njëjtën kërkesë, me shkresën nr. 1495/1 prot., datë 15.9.2022. AKBN-ja ktheu përgjigje me shkresën nr. 2037/3 prot., datë 16.9.2022, protokolluar në ERE me nr. 1495/2 prot., datë 20.9.2022, nga ku nuk rezulton që të jetë dhënë informacion shterues në lidhje me kapacitetin e shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. dhe të gjitha pyetjet e ERE-s.

- Bazuar në gjithë sa më sipër dhe referuar kompleksitetit të kësaj çështjeje, me qëllim marrjen dhe shterimin e të gjitha informacioneve përkatëse në lidhje me kapacitetin faktik me të cilin operon HEC-i Gizavesh i shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k., përpara marrjes së një vendimi përfundimtar në vijim të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së kësaj shoqërie, vlerësohet të shtyhet vendimmarrja e Bordit të ERE-s me 30

(tridhjetë) ditë kalendarike. Përfaqësuesi i shoqërisë vlerësoi gjithashtu të drejtë shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me sqarimin e plotë të kësaj çështje. Kjo shtyrje bazohet në nenin 92, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

- Përfaqësuesve të shoqërisë të pranishëm në mbledhje iu la detyrë që brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i vendimit të Bordit të ERE-s, të depozitojnë në ERE të gjithë dokumentacionin tekniko-financiar në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi për të gjitha asetet që shoqëria ka shtuar mbi listën e pajisjeve të impiantit për të cilën ajo është licencuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me heqjen e licencës së shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i vendimit të Bordit të ERE-s, shoqëria duhet të depozitojë në ERE të gjithë dokumentacionin tekniko-financiar në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi për të gjitha asetet që shoqëria ka shtuar mbi listën e pajisjeve të impiantit për të cilën ajo është licencuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë "Dosku-Energy" sh.p.k., dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 254, datë 7.10.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 242, DATË 23.9.2022, TË BORDIT TË ERE-s, MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SHA, LIDHUR ME KOSTOT QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË LLOGARITJEN E ÇMIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË PËR KLIENTËT FAMILJARË, ME KONSUM MBI 800 KWH NË MUAJ

Në mbështetje të neneve 1, 83, 85, pika 1 dhe 2, 90 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 12, nenit 105, germa "c", të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 584, datë 8.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", të ndryshuar; VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"; nenit 7, germa "g", të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë, që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 189, datë 23.11.2017, dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1773 prot., datë 6.10.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike, "Mbi një ndryshim në vendimin nr. 242, datë 23.9.2022, të Bordit të ERE-s, "Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj",

konstatoi se:

- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a. i ka dërguar Shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. dhe ERE-s shkresën me nr. 4820/6 prot., datë 5.10.2022, me

anë të së cilës ka bashkëlidhur vendimin nr. 10, datë 4.10.2022, të Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a., "Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., për muajin tetor 2022", dhe vendimin nr. 6490/5 prot., datë 5.10.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, "Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., për muajin tetor 2022", si dhe relacionin shpjegues mbi të cilin janë mbështetur këto vendime.

- Me datë 6.10.2022, ERE u njoh me vendimin nr. 6490/5 prot., datë 5.10.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, nga i cili rezulton ndryshimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a.

- Bazuar në nenin 5, pika 2, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", ndër të tjera përcakton, se: "... Shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për furnizimin e klientëve universalë, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë".

- Gjithashtu, neni 4, pika 7, e VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, përcaktohet se: "Ky vendim është i zbatueshëm edhe për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, sipas nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". Në vijim, shoqëria KESH sh.a. ka vendosur tarifimin për shitjen e energjisë elektrike për muajin tetor 2022, sipas tabelës më poshtë:

Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

- Ndër të tjera në relacionin shpjegues të KESH sh.a., mbi të cilin janë mbështetur vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të KESH sh.a., deklaron se përmirësimi i situatës hidrologjike në kaskadën e lumit Drin, si dhe rënia konsumit të energjisë elektrike të klientëve ,të cilët shërbehen nga FSHU sh.a. ka bërë të mundur mosekspozimin e KESH sh.a., në blerjen e energjisë elektrike në tregun e lirë.

- KESH sh.a. deklaron se situata financiare e shoqërisë për periudhën deri në fund të muajit tetor 2022, bën të mundur përballimin e nevojës për energji të FSHU sh.a., energji e cila do të ofrohet nga KESH sh.a., në zbatim të detyrimit të shërbimit publik.

- Shoqëria KESH sh.a. deklaron se prodhimi nga kaskada do të destinohet vetëm për mbulimin e konsumit të klientëve në TU, familjar, biznese në TU dhe klientë që furnizohen në TM në regjimin e FM-së niveli i tensionit 6/10/20 kV, çmimi i të cilëve është i mbrojtur.

- Shoqëria deklaron, se në kuadër të përditësimit periodik të situatës hidrike dhe aktivitetit do të përditësojë brenda datës 25 tetor 2022 Këshillin Mbikëqyrës dhe Asamblenë e Aksionarëve për të dhënat financiare dhe energjetike, me qëllimin e paraqitjes së situatës dhe marrjen e vendimeve të nevojshme për aplikimin e tarifimeve.

- Meqenëse me vendimin nr. 6490/5 prot., datë 5.10.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, çmimi i miratuar prej 2.6 lekësh/kwh për klientët familjarë dhe jofamiljarë në TU është i njëjtë me çmimin e njohur nga ERE, në përllogaritjen e kostove të blerjes së energjisë elektrike të FSHU sh.a., shprehur dhe në vendimin nr. 74, datë 13.4.2022, "Mbi vlerësimet e ERE-s për kostot e aktivitetit të furnizuesit të shërbimit universal, për periudhën 1.5.2022–31.12.2022", të Bordit të ERE, vlerësohet se për muajin tetor 2022, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen në kushtet e shërbimit universal nga FSHU sh.a., për muajin tetor 2022, të vijojnë të jenë ato të miratuara në vendimin nr. 74/2022 të Bordit të ERE-s.

- Bazuar në përmirësimin e treguesve teknikо-ekonomik, sikurse ka ndodhur së fundmi për muajin tetor 2022, në rastin se kostoja e blerjes së energjisë elektrike të FSHU sh.a., në zbatim të VKM-së nr. 456/2022, do të vijojnë të jenë ato të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të KESH sh.a., prej 2.6 lekësh/kwh, për të gjithë konsumatorët të cilët shërbehen në kushtet e Shërbimit Universal të Furnizimit.

- Në këto rrethana, ERE do të vijojë me ndryshimet përkatëse në vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, "Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a.,

lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj", duke lënë në fuqi çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike të miratuara me anë të vendimit nr. 74/2022 të Bordit të ERE-s, nëse do të ketë ndryshime të theksuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, si më poshtë:

- "Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekësh/kwh për konsumin mbi 800 kwh/muaj, për klientët familjarë, për periudhën 1 nëntor–31 dhjetor 2022".

2. Lënien në fuqi të çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike të FSHU sh.a., për konsumatorët familjarë, të miratuara me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, për muajin tetor 2022.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë FSHU sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 tetor 2022.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 135
Datë: 2022/10/13 15:00:26
777338f0-1248-4301-a74f-7111aa3ef1a7

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë